



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE  
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

**Raport monitorimi për periudhën Qershor - Dhjetor 2023**

**AGJENDA DIGJITALE E SHQIPËRISË 2022 – 2026**

**Janar 2024**

1.	Hyrje.....	3
2.	Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë .....	4
2.1.	Progresi i zbatimit të projekteve në kuadër të secilit Prioritet.....	5
2.2.	Gjendja bazuar në Raportin e Monitorimit për gjysmen e dytë të vitit 2023.....	8
3.	Informacion mbi projektet e parashikuara në planin e veprimit.....	11
4.	Konkluzione dhe rekomandime .....	22

## 1. Hyrje

Transformimi digjital i vazhdueshëm prek çdo aspekt së jetës sonë. Ne duhet ta përqafojmë atë dhe të sigurohemi se ka një efekt pozitiv mbi produktivitetin, rritjen, punësimin dhe mirëqenien – ndërsa përmbush synimet tona ambicioze të qëndrueshmërisë.

Agjenda Digjitale e Shqipërisë është një plan strategjik që synon të promovojë zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në vend.

Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026 synon të promovojë zhvillimin dhe përdorimin e TIK në vend për të shtyrë rritjen ekonomike, përmirësuar shërbimet publike dhe promovuar përfshirjen sociale.

Strategjia ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015–2020”, miratuar me vendimin nr. 284, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, luajti një rol të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit në vend. Prioritetet madhore të saj ishin: përmirësimi i infrastrukturës kombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, zhvillimi i qeverisjes elektronike, si dhe krijimi i Kadastrës Shumëqëllimshme. Plani i Veprimit u rishikua në vitin 2019. Në fazën e parë të implementimit 2015–2017 (objektivat afatmesëm), përpjekjet u përqendruan në zbatimin e projekteve për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës TIK, si dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurave për hartimin e politikave që rrjedhnin nga këto ndryshime. Faza e dytë, që përfshiu periudhën 2018–2020 (objektivat afatgjatë), synonte konsolidimin e arritjeve të realizuara në fazën e parë të zbatimit të strategjisë, duke përfshirë më tej aktivitete të reja në fushat kryesore të reformës administrative. Plani i Veprimit i Strategjisë së Agjendës Digjitale përfshinte në total 230 aktivitete bazë për t’u implementuar deri në vitin 2020, nga të cilat rezultoi se rreth 70% janë përfunduar. Pjesa e mbetur e aktiviteteve janë tjetërsuar apo nuk kanë gjetur fonde investimi.

Me realizimin me sukses të prioriteteve madhore të strategjisë 2015–2020, fokusi i aktiviteteve të agjendës së re digjitale, u drejtua drejt krijimit të një plani pune për të maksimizuar potencialin ekonomik dhe shoqëror të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përmirësimin të ofrimit të cilësisë së shërbimeve, duke parashikuar investime në integrimin e teknologjive të reja në sistemet elektronike qeveritare, si dhe përmirësimin e aftësive digjitale. Plani i ri i Veprimit do të shërbejë si katalizator për të koordinuar projektet e sektorit publik për modernizim dhe akses në TIK. Qeveria shqiptare aspirojnë prej kohësh të jetë më e hapur, më fleksibël dhe më interaktive në marrëdhëniet me qytetarët dhe bizneset, duke përdorur mjetet e TIK-ut, për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin me qëllim përmirësimin në vazhdimësi të shërbimeve publike

e-Qeverisja është menduar si një mënyrë për të rritur efektivitetin administrativ, sikurse edhe sjell përfitime si promovimi i vlerave demokratike dhe përfshirja e qytetarëve. Digjitalizimi i lejon qeveritë të veprojnë me transparencë dhe efikasitet më të madh. Në epokën digjitale, përdorimi i teknologjisë së informacionit ka potencial për të përmirësuar cilësinë e shërbimit publik, si në nivel qendror, ashtu edhe atë vendor.

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka investuar gjithnjë e më shumë në krijimin e një strukture dhe kulture solide të qeverisjes elektronike, me implikime të drejtpërdrejta në transformimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve publike. Qeveria ka treguar një angazhim të palëkundur për të avancuar drejt shërbimeve online. Si rezultat, e-Qeverisja është sot një realitet i prekshëm në Shqipëri. Portali i shërbimeve online (e-Albania) tani ofron deri në 1,237 shërbime publike online, ose rreth 95% e gjithë shërbimeve publike të shtetit shqiptar, nga vetëm 14 shërbime të ofruara me fillimin e ndryshimit digjital rreth një dekadë më parë.

Pas shërbimeve elektronike të ofruara qëndron një arkitekturë komplekse, Platforma Qeveritare e Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Deri më sot janë 60 regjistra elektronikë, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin në kohë reale, duke bërë që mesatarisht 66% e formularit të aplikimit të plotësohet automatikisht në e-Albania, duke shkurtuar kohën e dhënies së shërbimit dhe duke thjeshtuar më tej procedurat.

Për të gjitha shërbimet publike që aplikohet në e-Albania, prej muajit maj 2022 përgjigjja merret elektronikisht nga institucioni shërbim-ofrues, vetëm me vulë ose nënshkrim elektronik. Kjo ka çuar në reduktimin ndjeshëm të sporteve fizike.

## 2. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë

Agjenda Digjitale e Shqipërisë është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 1.6.2022.

Strategjia monitorohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e strategjisë ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026”. Kjo strategji, mbështetur në urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” dhe urdhrin nr. 844, datë 24.12.2018, “Për ngritjen e Sekretariatit Teknik, në kuadër të funksionimit të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) në fushën e e-qeverisjes dhe digjitalizimit”, është strategji e hartuar në përputhje me Agjendat Digjitale Evropiane.

Kriteret e nevojshme për zbatimin efikas dhe të suksesshëm të “Agjendës Digjitale të Shqipërisë 2022–2026” janë si më poshtë vijon:

- Marrëveshje dhe bashkëpunim të sinkronizuar midis institucioneve për të realizuar synimet digjitale të qeverisë dhe aktivitetet e planifikuara;
- Zbatimi i aktiviteteve sipas prioriteteve dhe qëllimeve të përbashkëta, si dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme për realizimin e tyre;
- Përcjellja dhe njohja e institucioneve publike e private, si dhe qytetarëve me objektivat kryesorë digjitale të qeverisë;

- Sistem monitorues dhe vlerësues për realizimin e qëllimeve të strategjisë, me synim evidentimin e problematikave, si dhe përshtatjen e aktiviteteve në përputhje me situatat aktuale;
- Nxitja e bashkëpunimit mes institucioneve publike, organizatave vendase e të huaja, organizatave jo fitimprurëse etj.;
- Monitorimi i shpeshtë i strategjisë dhe aktiviteteve, duke analizuar treguesit, qëllimet, arritjet, pengesat dhe pasojat e planit të veprimit.

Lista e plotë e treguesve jepet në kapitullin 9 “Pasaporta e indikatorëve të Agjendës Digjitale”. Treguesit do të vlerësohen në mënyrë periodike nga institucionet publike sipas ndarjes së punës dhe fushës së tyre të juridiksionit. Bazuar në këto tregues, AKSHI do të prodhojë raporte vjetore të ecurisë së strategjisë, të cilat do të jenë publike. Për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit efektiv të planit të veprimit, AKSHI do të prodhojë raporte 6-mujore dhe vjetore. Gjithashtu, një nga elementet bazë të sistemit të monitorimit të strategjisë “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026”, do të jetë monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe rezultateve të saj nga organizata të specializuara e të interesuara të shoqërisë civile apo media.

## 2.1. Progresi i zbatimit të projekteve në kuadër të secilit Prioritet

Plani i Veprimit i Strategjisë së Agjendës Digjitale 2022 - 2026 përfshin në total 47 aktivitete bazë për t’u implementuar deri më vitin 2026.

Nga këto 47 aktivitete, deri në dhjetor të vitit 2023 rezulton se 16 aktivitete ishin realizuar, 11 aktivitete kishin filluar implementimin dhe ishin në proces zbatimi, 9 aktivitete janë në proces të ngritjes së termave të referencës dhe 9 aktivitete nuk kishin nisur ende implementimin sepse ishin tjetërsuar, nuk kishin gjetur fonde investimi, apo ishin në proces hartimi/rishikimi të termave të referencës.

*Prioriteti i parë “Qeveria digjitale: Mundësimi i politikave digjitale, proceseve inteligjente dhe zgjidhjeve të përparuara në platforma të sigurt” ka në total 22 aktivitete, ndër te cilat 8 aktivitete janë realizuar, 5 aktivitete janë në proces zbatimi, 5 aktivitete janë në fazë hartimi të termave të referencës dhe 4 aktivitete nuk kanë nisur ende zbatimin.*

Nr	Masat për prioritetin 1 “Qeveria digjitale”	Afat fillimi	Statusi
1	Përmirësimi i sistemit e-Gjopa (përfshirja e Policisë Bashkiake) dhe plotësimi me tableta	2022	Realizuar
2	Përmirësimi i Sistemit të të Huajve (FER)	2022	Realizuar
3	Ngritja e Regjistrat Elektronik të Vizitave në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale	2022	Realizuar
4	Ngritja e Regjistrat të Rekordëve Korruptive	2022	Realizuar
5	Sistemi i Hartës Digjitale për hapësira publike të mbuluara me kamera sigurie	2022	Realizuar

6	Studimi i fizibilitetit për Zgjerimin e Rrjetit Qeveritar (GovNet) për të siguruar komunikim më të shpejtë, të besueshëm dhe të sigurt midis ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor	2022	Në proces
7	Studimi i fizibilitetit për krijimin e Qendrës me Performancë të Lartë Kompjuterike*	2022	Në proces
8	Studimi i Fizibilitetit për Krijimin e një rrjeti të sigurt të shkëmbimit të informacionit për të mundësuar ndërveprimin rajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor*	2022	Në proces
9	Studim fizibiliteti për Themelimin e Qendrës Kombëtare të Sigurisë Kibernetike & Qendrës Qeveritare të Sigurisë Kibernetike	2022	Realizuar
10	Implementimi i Strategjisë Paperless për administratën publike	2022	Realizuar
11	Ngritja e Sistemit të Kartës së Tahogرافit	2022	Proces hartimi të termave të referencës.
12	Përmirësim i Sistemit të Monitorimit të Pyjeve me Dronë për Monitorimin e Pyjeve dhe Ujërave	2022	Proces hartimi të termave të referencës
13	Zgjerimi i Sistemit të numrit të unifikuar të emergjencave 112	2022	Nuk ka filluar implementimi
14	Përmirësimi i Sistemit TIMS	2022	Proces hartimi të termave të referencës
15	Përmirësimi i Sistemit Menaxhimi i Çështjeve	2022	Proces hartimi të termave të referencës
16	Përmirësimi i Sistemit të Komunikimit të Policisë Datacom	2023	Në proces
17	Përmirësimi i Sistemit të Informacionit për Arkivin Qendror të Filmit	2023	Nuk ka filluar implementimi
18	Përmirësimi i Infrastruktura TIK për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (duke përfshirë kamera, akses kontroll, mbrojtje perimetrale, skanerë bagazhesh, radio komunikimi, komunikimin e të burgosurve me jashtë)	2023	Në proces
19	Zbatimi i Hybrid Cloud për njësitë e qeverisjes vendore, startup-s dhe palët e treta	2024	Realizuar
20	Riinxhinierimi i Portalit e-Albania	2023	Proces hartimi të termave të referencës.

21	Ngritja e sistemit API dhe PNR	2023	Nuk ka filluar implementimi
22	Blerje shërbim mbikëqyrje elektronike	2023	Nuk ka filluar implementimi

\*Projekti 7 dhe 8 janë bashkuar në një projekt të vetëm

*Prioriteti i dytë: ‘Biznesi digjital: Shërbime të aksesueshme, proaktive dhe veprime të gatshme për biznes’ ka në total 6 aktivitete.*

Ndër keto aktivitete, 2 aktivitete janë realizuar, 1 aktivitetet është në proces zbatimi dhe 3 aktivitete nuk kanë nisur ende zbatimin.

Nr	Masat për prioritetin 2 “Biznesi Digjital”	Afat fillimi	Statusi
1	Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare	2022	Realizuar/ fazë testimesh
2	Ngritja e regjistrat të fermës	2022	Në proces
3	Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin IPARD	2023	Nuk ka filluar implementimi
4	Përmirësimi i Sistemit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit	2023	Nuk ka filluar implementimi
5	Përmirësimi i Sistemit të Kadastrës së Ujit	2024	Nuk ka filluar implementimi
6	Përmirësimi i Sistemit të Qendrës Kombëtare të Biznesit	2023	Realizuar

*Prioriteti i tretë “Qytetarët digjitalë: qytetarët dhe privatësia, transparenca e të dhënave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve” ka 16 aktivitete.*

Ndër keto aktivitete, 7 aktivitete janë realizuar, 4 janë në proces, 4 aktivitete janë në fazë hartimi të termave të referencës dhe 1 aktivitet nuk ka nisur ende.

Nr	Masat për prioritetin 3 “Qytetarët digjitalë”	Afat fillimi	Statusi
1	Përmirësimi i Sistemit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	2022	Realizuar
2	Përmirësimi i sistemit të vaksinimit	2022	Realizuar
3	Ligji i qeverisjes elektronike	2022	Realizuar
4	Përshtatja e Portalit Qeveritar dhe website-eve zyrtare për personat me aftësi të kufizuara	2022	Në proces
5	Përmirësimi i sistemit të sëmundshmërisë	2022	Nuk ka filluar implementimin
6	Ngritja e resë digjitale për kulturën	2022	Proces hartimi të termave të referencës.

7	Përmirësim, digjitalizim dhe integrim i sistemeve IKRKT dhe IKTK	2022	Proces hartimi të termave të referencës.
8	Zgjerimi i Sistemit të Informacionit Spitalor rajonal në pjesën e mbetur të spitaleve dhe zbatimi i PACS	2023	Në proces
9	Përmirësimi i sistemit të referimit për ekzaminime të avancuara mjekësore (e-Referimi)	2023	Realizuar
10	Përmirësimi i sistemit të institutit të sigurimeve shoqërore	2023	Realizuar
11	Përmirësimi i sistemit të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile	2023	Nuk ka filluar implementimin
12	Përmirësim i sistemit të Regjistrat Kombëtar të Adresave	2024	Realizuar
13	Përmirësimi i Sistemit të Biletave Elektronike për Sitet Kulturore	2023	Realizuar
14	Përmirësimi i sistemit të emergjencave civile	2023	Proces hartimi të termave të referencës.
15	Ndertimi i Qendres me Performance të Lartë Kompjuterike - përdorimi i Big Data dhe IA për kërkim shkencor dhe ofrimin e shërbimeve proaktive	2023	Në fazë konceptimi
16	Transpozimi i Direktives (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 26 tetor 2016 mbi aksesimin e uebfaqeve dhe aplikacioneve mobile të sektorit publik	2023	Në proces

Prioriteti i katërt “Edukimi digjital dhe aftësitë digjitale: transformimi i të mësuarit dhe mësimdhënies” ka 3 aktivitete, ndër të cilat 1 aktivitet është në proces zbatimi dhe 2 aktivitete nuk e kanë filluar akoma zbatimin.

Nr	Masat për prioritetin 4 “Edukimi digjital”	Afat fillimi	Statusi
1	Implementimi i strategjisë për digjital skills	2022	Në proces
2	Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë	2023	Nuk ka filluar implementimin
3	Lidhja e institucioneve arsimore në qeveri	2024	Nuk ka filluar implementimin


## 2.2. Gjendja bazuar në Raportin e Monitorimit për gjysmën e dytë të vitit 2023

Progresi i zbatimit të Planit të Veprimit 2022-2026 për periudhën qershor-dhjetor 2023 është në total **60% i zbatuar/në proces**, siç paraqitet më poshtë:



Nga 47 aktivitete në total:

- **17 projekte janë realizuar plotësisht**
- **10 projekte janë në proces**
- **9 projekte janë në proces hartimi të termave të referencës dhe në fazë konceptimi.**
- **11 projekte nuk kanë nisur ende**



- I. **Prioriteti i parë:** 22 aktivitete në total, nga të cilat **36,3% e aktiviteteve janë realizuar plotësisht, 22,7% janë në proces, 22,7% janë në fazë hartimi të termave të referencës dhe 18% nuk kanë filluar ende.**
- II. **Prioriteti i dytë,** 6 aktivitete gjithsej, nga te cilat 33,3% e tyre janë realizuar, 16,6% janë në proces dhe 50% e aktiviteteve nuk kanë nisur ende implementimin.
- III. **Prioriteti i tretë,** gjithsej 16 aktivitete, nga të cilat **43,7% e aktiviteteve janë realizuar plotësisht, 18,7% janë në proces, 25% janë në fazë hartimi të termave të referencës dhe 12,5% nuk kanë filluar ende.**
- IV. **Prioriteti i katërt,** 3 aktivitete në total, 34% e aktiviteteve janë në proces zbatimi dhe 66% e tyre nuk ka filluar ende implementimin.


#### **Aktivitetet me afat mbarimi vitin 2023:**

Nga 19 aktivitete ne total:

- 9 projekte janë realizuar plotësisht

- 4 projekte janë në proces
- 6 projekte nuk kanë nisur ende

**47.37%** e projekteve me afat mbarimi vitin 2023 janë të përfunduara, **21%** e projekteve janë në proces dhe **31.5%** e projekteve nuk kanë nisur ende.



**Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit** ka rritur numrin e shërbimeve elektronike të ofruara online me impakt deri në dhjetor 2023, në 3,074,325 përdorues ku përfshihen qytetarë, biznese dhe punonjës të administratës publike. Per periudhen qershor - dhjetor 2023 janë regjistruar në portalin e-Albania 119,729 përdorues të rinj duke e çuar numrin e përdoruesve në 3,074,325 përdorues.

**Numri i dokumenteve të vulosura elektronike** të shkarkuara në janar - qershor 2023: 3.7 milion dokumenta me vule elektronike.

**Numri i përdoruesve të regjistruar** në qershor - dhjetor 2023:

Numri i transaksioneve vjetore në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë e shkëmbimit të të dhënave mes sistemeve elektronike në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt, arriti në **195 milionë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023**, ose 297 milionë për gjithë vitin 2023. Shkëmbejnë te dhëna **60 sisteme elektronike**.

#### **Arritjet kryesore gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023:**

- Numri i shërbimeve elektornike qe ofrohen online aktualisht ne portalin e-Albania eshte 1237 . Portali qeveritar e-Albania vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke ofruar aktualisht 95% të të gjithë shërbimeve

publike, (shërbime të cilat realizohen plotësisht online dhe nuk kanë nevojë për prezencë fizike të individit, mjetit apo mostër laboratorike);

- e-Albania është e lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë dhe që mundëson ndërveprimin me bazat e të dhënave shtetërore dhe shkëmbimit të të dhënave në kohë reale midis 60 sistemeve elektronike duke bërë të mundur automatizimin e procedurave administrative në trajtimin e tyre si dhe eliminimin e dokumenteve shoqëruese. Gjithashtu falë këtij ndërveprimi me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit mundësohet plotësimi automatikisht i 68% të fushave në formularët e aplikimit, duke ndihmuar në thjeshtimin e aplikimeve për qytetarët dhe bizneset dhe duke reduktuar dhe dokumentet shoqëruese të tyre;
- Numri i transaksioneve vjetore në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë e shkëmbimit të të dhënave mes sistemeve elektronike në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt, arriti në më shumë se 297 milionë gjatë kesaj periudhe;
- e-Albania u ka kursyer qytetarëve dhe bizneseve rreth 1000 vite pritje nëpër radhë për marrjen e dokumenteve shtetërore me vulë elektronike dhe rreth 9 milionë EUR në xhepat e tyre, nga heqja e tarifave të këtyre dokumenteve që ofrohen tashmë pa pagesë në platformë në versionin e tyre elektronik;
- Gjatë vitit 2023 janë marrë nëpërmjet portalit e-Albania 13.2 milionë shërbime publike nga te cilat janë gjeneruar 8.7 milionë dokumente me vulë elektronike në e-Albania;
- 47,000 dokumente shoqëruese për shërbimet e ofruara në portalin e-Albania janë shkëmbyer përmes Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE), mes punonjësve të administratës gjatë kesaj periudhe;
- Rrjeti Qeveritar (GovNet) ndërlidh më shumë se 250 institucione publike në Tiranë;
- Në gjysmën e dytë të vitit 2023 janë regjistruar në portalin qeveritar e-Albania 119,729 përdorues të rinj duke e çuar në 3,074,325 numrin total të përdoruesve të regjistruar;
- Qasja e portalit qeveritar e-Albania ndaj digjitalizimit të shërbimeve është vlerësuar edhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare, nga OKB-ja, OECD-ja, Departamenti i Amerikan Shtetit dhe Komisioni Evropian, të cilët i japin Shqipërisë notën maksimale në qeverisjen digjitale.

### 3. Informacion mbi projektet e parashikuara në planin e veprimit

- **Studimi i fizibilitetit për Zgjerimin e Rrjetit Qeveritar (GovNet) për të siguruar komunikim më të shpejtë, të besueshëm dhe të sigurt midis ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor**

Qeveria shqiptare e identifikon ndërlidhjen digjitale dhe infrastrukturën broadband si një prioritet kyç në dokumentet e saj strategjike. Një nga rrjetet kyçe në përdorim është Rrjeti Qeveritar (GovNet) i cili ndërlidh më shumë se 230 institucione publike në Tiranë. Ai është gjithashtu rrjeti kryesor i infrastrukturës i përdorur nga Platforma Qeveritare të Ndërveprimit.

Në mënyrë që GovNet të jetë në gjendje të mbështesë prioritetet kryesore strategjike, si në aspektin e besueshmërisë ashtu edhe të sigurisë, shtylla kurrizore e fibrave duhet të shtrihet në nivel kombëtar, duke lidhur çdo qytet në vend.

Do të synohet shtrirja e rrjetit GovNet në të gjithë Shqipërinë për të përmirësuar aksesin në shërbimet online dhe për të siguruar që institucionet rajonale të administratës publike të kenë akses dhe komunikim të sigurt në të gjitha shërbimet elektronike të qendëruara. Ky investim do të mundësojë po ashtu garantimin e përdorimit më të shpejtë dhe të pandërprerë të çdo funksionaliteti të sistemeve ekzistuese elektronike, pavarësisht vendndodhjes së largët të përdoruesve.

*Statusi qershor 2023:*

Është fituar Asistenca Teknike për studim fizibiliteti nga WBIF, në pritje të fillimit të implementimit

- **Studimi i Fizibilitetit për krijimin e Qendrës me Performancë të Lartë Kompjuterike dhe ngritjen e një rrjeti të sigurt shkëmbimi informacioni për të mundësuar ndërveprimin rajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor**

Qëllimi i projektit:

1. Themelimi i një qendre informatike me performancë të lartë për të dhënat e institucioneve qeveritare
2. Vendosja e një rrjeti të sigurt të shkëmbimit të informacionit për të mundësuar ndërveprimin rajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Qendra HPC do të mundësojë analizë nga të dhënat e disponueshme në sisteme të ndryshme të administratës publike, në kohë reale dhe përpunimit të qindra miliona rekordeve në të njëjtën kohë.

Vendosja e një rrjeti të sigurt të shkëmbimit të informacionit do të përmirësojë, modernizojë, rrisë sigurinë dhe disponueshmërinë e Platformës Qeveritare të Ndërveprimit me qëllim të përafrimit të tij me standardet dhe kërkesat rajonale të ndërveprimit.

*Statusi dhjetor 2023:*

Proces hartimi të termave të referencës.

- **Zgjerimi i Sistemit të numrit të unifikuar të emergjencave 112**

Neni 47 pika 3 e ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, përcakton se ngritja dhe funksionimi i sistemit për numrin e unifikuar të urgjencës 112 do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të përbashkët të ministrit. përgjegjës për emergjencat civile dhe ministrin përgjegjës për punët e brendshme. Referuar ligjit të mësipërm, sistemi i numrave të urgjencës

112 do të jetë në inventar dhe do të përdoret nga emergjencat civile. Për këtë, Ministria e Mbrojtjes ka propozuar miratimin e një urdhri të përbashkët për ngritjen e një grupi ndërinstitucional që do të hartojë projektvendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2022, Policia e Shtetit ka kryer procedurat për rikonstruksionin e sallave të operacionit për zbatimin e Numrit të Unifikuar të Urgjencës 112 dhe projekti është në zbatim. Termat e Referencës për shtrirjen e numrit të urgjencës 112 në të gjithë Shqipërinë janë përshtatur muajt e fundit për të pasqyruar dinamikën e zhvillimeve të fundit teknologjike, duke synuar një përmirësim të veçorive të sistemit. Ato po shqyrtohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, pasi numri 112 po kalon në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

*Statusi dhjetor 2023:*

Projekt i maturuar por nuk ka buxhet

#### ➤ **Implementimi i Strategjisë Paperless për Administratën publike**

Qëllimi kryesor i nismave për qeverisjen digjitale dhe digjitalizimin e shërbimeve është fuqizimi i qytetarëve, bizneseve dhe rritja e efikasitetit në administratën shtetërore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike, aksesit në rritje në informacionin publik, transparencës dhe mjeteve efektive për përfshirjen e qytetarëve në procesin e politikave. Revolucioni digjital i shërbimeve publike në Shqipëri ka ndryshuar prej kohësh perceptimin e qytetarëve, në lidhje me komunikimin elektronik me institucionet shtetërore, dhe sot mundësohen 1,227 shërbime online ose rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike.

Qeveria shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve offline në shërbime online, e shndërroi **platformën e-Albania**, e cila në 2013 kishte vetëm 14 shërbime elektronike, në një histori sukcesi dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të rivendoste besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Një gamë e madhe shërbimesh publike që dikur ofroheshin vetëm në modelin tradicional, që kërkonin paraqitje në zyrat përkatëse, aplikim shkresor, pritje në radhë, plotësim formularësh etj., sot merren në rrugë elektronike, me një sportel, nga një aparat telefoni smartphone, një kompjuter në shtëpi.

Ndërveprimi i Platformës Qeveritare të Ndërveprimit me bazat e të dhënave shtetërore falë webservice-ve të ngritura mundëson lehtësimin e procedurës së aplikimit të qytetarëve përmes plotësimit automatik të një pjese të formularit të aplikimit. Momentalisht, rreth 66% e fushave të formularëve online në e-albania janë prefilled.

Te gjithë shërbimet elektronike të ofruara në portal janë të dedikuara për një gamë të gjerë kategorish përdoruesish, duke filluar nga të punësuarit, të papunët, drejtuesit e mjeteve, pronarët e pronave, nxënësit, pensionistët, qytetarët shqiptarë jashtë vendit por edhe ata të huaj që interesohen për të marrë shërbime në Shqipëri, e deri te bizneset dhe vetë punonjësit e administratës publike.

Në platformë ofrohen shërbime që janë riinxhinierizuar 100% duke ofruar një shërbim tërësisht paperless.

Administrata nuk është më e njëjta. Qytetarët dhe bizneset **nuk mbledhin më dokumente e vërtetime**, pasi janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve.

E gjithë veprimtaria bazohet në një kornizë të posaçme ligjore, e cila ka ecur paralelisht me të gjitha proceset e implementimit teknik të procedurave, për zhvillimin e e-Qeverisjes në vend.

#### *Statusi dhjetor 2023:*

Për të gjitha shërbimet publike që aplikohet në e-Albania, prej muajit maj 2022 përgjigjja merret në formë paperless nga institucioni shërbim-ofrues, vetëm me vulë ose nënshkrim elektronik. Kjo ka çuar në reduktimin ndjeshëm të sporteleve fizike dhe letrës.

### ➤ **Implementimi i strategjisë për digital skills**

Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ka ndërmarrë një nismë e cila ka filluar zbatimin në vitin shkollor 2022-2023, për të zhvilluar kompetencat digjitale tek fëmijët dhe të rinjtë. Ky program përkon specifikisht me përfshirjen e lëndës “TIK dhe kodim” në klasat I, II dhe III në mënyrë interaktive, dhe në vijim, riformatimin e mësimdhënies së lëndës së TIK në klasat IV-XII në mënyrat më bashkëkohore dhe për t'u mundësuar nxënësve më shumë njohuri praktike në këtë fushë, pajisjen e të gjitha shkollave të arsimit parauniversitar me laboratorë smart të aksesueshëm nga të gjithë nxënësit, si dhe me përgatitjen e mësuesve të lëndës së TIK në arsimin parauniversitar për mësimdhënien e lëndës në mënyrë interaktive dhe në përshtatje me kurrikulat, platformat dhe pajisjet bashkëkohore.

Faza e parë e projektit të kodimit në shkolla po implementohet në klasat e para në 100 shkolla për vitin shkollor 2022-2023. Faza e dytë e këtij projekti, përgjatë viteve 2023-2025, synon ndërtimin e laboratorëve smart në 884 shkolla të arsimit parauniversitar në Shqipëri, shtrirjen e mësimdhënies për klasat e para në 984 shkollat me laboratorë dhe pilotimin e programit në klasat e dyta dhe të treta të 100 shkollave që u përfshinë në fazën e parë të implementimit të projektit.

Gjatë fazave të mëtejshme të projektit deri në vitin 2030 synohet pilotimi dhe shtrirja graduale e zbatimit të kurrikulës së re të TIK-ut të bazuar në platformë interaktive në të gjitha klasat e shkollave të arsimit parauniversitar, trajnimi i të gjithë mësuesve të TIK-ut mbi mësimdhënien e lëndës në mënyrë bashkëkohore, dhe pajisja e të gjitha shkollave të arsimit bazë me laboratorë teknologjikë të përshtatshëm për mësimdhënien e lëndës së TIK në kushtet më optimale.

#### *Statusi dhjetor 2023:*

Është dakordësuar paraprakisht programi “Përmirësimi i aksesit universal në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet teknologjisë (Govtech)” me Bankën Botërore, pjesë e së cilit do të jetë ndërtimi i 200 laboratorëve në shkollat e arsimit universitar, gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, është përfituar grant investimi nga WBIF dhe kredi investimi nga CEB për 684 labe të tjera të arsimit parauniversitar. Implementimi i projektit “Krijimi i Smart Labs – rrjeti i laboratorëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për arsimin parauniversitar” pritet të fillojë gjatë vitit 2024.

➤ **Studim fizibiliteti për Themelimin e Qendrës Kombëtare të Sigurisë Kibernetike & Qendrës Qeveritare të Sigurisë Kibernetike**

Është duke u ngritur Qendra Qeveritare e Sigurisë Kibernetike (Gov-SOC), e cila do të jetë përgjegjëse për monitorimin dhe përgjigjen ndaj çdo aktiviteti në rrjetin qeveritar. Monitorimi do të kryhet nëpërmjet zgjidhjeve të Microsoft:

- Defender for Identity (MDI)
- Defender for Endpoint (MDE)
- Defender for Office
- Defender for Cloud
- Konformiteti i pajisjeve fundore (Intune)
- Konformiteti i serverave (SCCM)

Krahas këtyre zgjidhjeve, do të përdoret informacioni i marrë nga pajisjet e tjera të rrjetit si Firewall, Web application Firewall, për plotësimin e një pamje të qartë të gjithçkaje ndodh në rrjet. Të gjithë këto Burime informacioni do të korelohen në një zgjidhje të vetme që është Sentinel.

Sentinel është një mjet i fuqishëm që kryen analizimin, nëpërmjet funksionaliteteve të saj të Inteligjencës artificiale, e të gjithë informacioneve nga Burime të ndryshme dhe përgatit përgjigje të automatizuara, të menjëhershme në rast aktivitetesh të dyshimta. Kjo zgjidhje është renditur këtë vit si zgjidhja më e mirë SIEM (Security Information and Event Management).

Qendra Operacionale e Sigurisë do të ketë një vizibilitet të plotë të gjithë mjedisit kibernetik dhe do të monitorojë krahas aktiviteteve edhe vulnerabilitetet, përditësimet (patch-imet) dhe kontrollet për Indikatorë të mundshëm kompromentimi.

Punonjësit e SOC do të kenë dhe mundësinë për të raportuar në kohë reale incidentet edhe me SOC-un kombëtar.

*Statusi dhjetor 2023:*

AKSHI ka krijuar dhe funksionon Qendrën Operacionale të Sigurisë Qeveritare në shkurt 2023. Kjo qendër (SOC) është përgjegjëse për monitorimin dhe reagimin ndaj çdo aktiviteti në rrjetin qeveritar. Monitorimi kryhet nëpërmjet zgjidhjeve të Microsoft. Përveç këtyre zgjidhjeve, informacioni i marrë nga pajisjet e tjera të rrjetit si Firewall-i, Firewall-i i aplikacioneve në web ose teknologji të ndryshme në përdorim, përdoren për të marrë një pamje të qartë të gjithçkaje që ndodh në rrjet. Të gjitha këto burime informacioni janë i ndërlidhur në një zgjidhje të vetme që është Microsoft Sentinel. Sentinel është një mjet i fuqishëm që analizon, nëpërmjet funksionalitetit

të tij të inteligjencës artificiale, të gjitha informacionet nga burime të ndryshme dhe përgatit përgjigje të automatizuara, të menjëhershme në rast të aktiviteteve të dyshimta.

Qendra e Sigurisë Operacionale ka shikueshmëri të plotë të të gjithë mjedisit kibernetik qeveritar dhe monitoron, përveç aktiviteteve, dobësive, përditësimeve (arnimeve) dhe kontrolleve për tregues të mundshëm kompromisi.

Punonjësit e SOC-ut mund të raportojnë incidentet në kohë reale edhe me KOS-in kombëtar. Së bashku me krijimin e SOC-ut qeveritar, Drejtoria e Monitorimit dhe Mbrojtjes Kibernetike për Sistemet dhe Infrastrukturat e Qeverisjes elektronike tani është ristrukturuar dhe zgjeruar, dhe përbëhet nga 3 sektorë funksionale.

### ➤ **Përmirësimi i sistemit FER (Foreign Electronic Register)**

Objekti i përgjithshëm i projektit është automatizimi i procesit të trajtimit të aplikimeve për leje qëndrimi nga të huajt dhe të gjithë palët e përfshira në lëshimin verifikimin e lejes nëpërmjet integritit me sistemet e tjera, shërbimeve të dedikuara në e-albania dhe trajtimi i lejes deri në lëshimin e saj me vulë elektronike në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe marrëveshjet në kuadër të Open Ballkan.

Sistem elektronik qendror menaxhon procedurat e aplikimit të lejeve të qëndrimit për të huajt dhe ndjekjen e të gjitha proceseve deri në dhënien e lejes me vulë elektronike, duke përfshirë edhe komunikimin me sisteme të treta. Projekti mundëson edhe një shërbim të dedikuar për qytetarin në e-Albania, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve të Open Ballkan.

Në kuadër të këtij projekti, u riorganizuan dhe informatizuan proceset aktuale të punës në shqyrtimin e aplikimit për leje nga të huajt në të gjitha strukturat e përfshira në lëshimin e saj, me qëllim përmirësimin, harmonizimin dhe adresimin më së miri të problematikave dhe përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi. U krye trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit përdorues të sistemit, që të jenë në gjendje të përdorin këtë sistem në mënyrë sa më efikase.

Një nga qëllimet kryesore të këtij projekti është rritja e transparencës në procedurat në lidhje me procesin e plotë nga aplikimi deri në aprovimin e lejes. U mundësua një procedurë aplikimi më e thjeshtë dhe më efiçente e lejeve për të huajt, si dhe të të gjitha palëve të interesuara në evidentimin e saktë të shtetasve të kalimit tranzit, nëpërmjet rrugëve të ligjshme, por dhe të paligjshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të këtij projekti, do të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara në Open Balkan midis Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Në këtë mënyrë, do të minimizohen kostot administrative dhe koha nga regjistrimi deri në shqyrtimin e një leje, duke eliminuar prezencën fizike të të huajve në Shqipëri në momentin e aplikimit, i cili do të kryhet vetëm online, duke përfshirë aplikimin së bashku me dokumentet shoqëruese dhe strukturat përgjegjëse do e trajtojnë sipas procedurave.

Shërbime në portalin qeveritar e-Albania që administrohen nëpërmjet sistemit FER:



1. Kërkesë për leje qëndrimi / Residence permit:

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15308](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15308)

2. Kërkesë për rinovim të lejes së qëndrimit / Renewal residence permit request

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15309](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15309)

3. Aplikim për Leje Unike / Unique permit

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15146](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15146)

4. Aplikim për rinovim Leje Unike / Renewal unique permit

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=15386i](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15386i)

*Statusi dhjetor 2023:*

Implementimi ka përfunduar me date 24.11.2022. Mirëmbajtja e sistemit ka filluar me date 25.11.2022 dhe vazhdon për 24 muaj.

- **Sistemi elektronik i menaxhimit të denoncimeve mbi rekordet korruptive - për Ministrinë e Drejtësisë**

Nëpërmjet këtij projekti u ngrit sistemi elektronik për menaxhimin e rasteve korruptive të denoncuar nga qytetarët. Sistemi mundëson ndjekjen e rastit të denoncuar përgjatë të gjithë ciklit nga krijimi i denoncimit deri në përfundim të trajtimit të tij nga institucioni.

*Statusi dhjetor 2023:*

Deri në fund të vitit 2022, janë realizuar:

1. Analizimi i situatës aktuale dhe përcaktimi i planit të punës për ekzekutimin e projektit dhe zhvillimin e aplikacionit.
2. Furnizimin e pajisjeve hardware në përputhje me specifikimet teknike.
3. Instalimet fizike për të gjitha pajisjet e propozuara në rack
4. Konfigurime të nevojshme të infrastrukturës dhe programeve ndihmëse.
5. Ndërveprimi me sistemet e tjera si QKB, DPGJC, DPT, DAP.
6. Është kryer integrimi i nënshkrimit elektronik në sistem.

Vijon puna për:

1. Integrimin e sistemit me sistemin “Shqipëria që Duam”
2. Integrimi i Single Sign On

Pas finalizimit të dy pikave të mësipërme do bëhet trajnimi i përdoruesve dhe vënia në punë e sistemit.

➤ **Përmirësimi i Sistemit të Regjistrimit të Kontrollit të Barnave (SIRKB) bazuar në platformën Oracle E-Business Suite R12 (12.2).**

Projekti synoi ndërtimin e regjistrimit elektronik të regjistrimit të pajisjeve mjekësore (RPM), platformën Oracle E-Business Suite R12(12.2) Inventory - për regjistrimin dhe inventarimin e pajisjeve mjekësore, me teknologji web Oracle Forms për:

- Pajisjet mjekësore të të gjitha klasave
- Pajisjet mjekësore in-vitro
- Pajisjet mjekësore të implementueshme aktive
- Pajisjet mjekësore me porosi
- Sistemet apo paketat procedurale.

Gjithashtu u mundësua ndërveprim me sistemet në vijim:

- Sistemi i Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile
- Sistemi i Qendrës Kombëtare të Biznesit
- Sistemin e-Rx

Projekti solli edhe shtimin e shërbimeve elektronike në portalin e-albania dhe integrimin me RSS (Remote Signing System) për:

- Aplikim për autorizim importi
- Aplikim për autorizim zhdoganimi
- Aplikim për regjistrim pajisje mjekësore
- Aplikim për ndryshim pajisje mjekësore
- Aplikim për anulim pajisje mjekësore
- Aplikim për vetëdeklarimin nga subjektet për importet e pajisjeve mjekësore

Sistemi mundëson gjenerimin e dokumenteve me vulë elektronike si autorizim importi, autorizim zhdoganimi, leje e hedhjes në treg, certifikatë regjistrimi dhe certifikatë ndryshimi të regjistrimit ekzistues.

Projekti solli integrim të plotë të sistemit informatik të regjistrimit të kontrollit të barnave, me teknologji software të unifikuar me Regjistrin Elektronik të Regjistrimit të Pajisjeve Mjekësore.

*Statusi dhjetor 2023:*

Realizuar

➤ **Përmirësimi i sistemit e-Gjoba, integrimi me pajisjet mbështetëse radar dhe plotësimi me tableta për policinë e shtetit**

Projekti synon pajisjen e 250 agjentëve të tjerë të policisë rrugore me pajisjet e nevojshme për vendosjen e gjobave elektronike si dhe pajisjen me 25 tabletë për supervizorët e agjentëve. Zgjidhja software, nëpërmjet funksionaliteteve të reja do të mundësojë vëzhgimin e punës së agjentëve në terren. Përmirësimi i sistemit do të kryhet konform ndryshimeve të Kodit Rrugor datë 7.5.2021.

Përmes projektit mundësohet ndërveprimi i sistemeve të Policive Bashkiake me sistemin e-Gjoba. Gjithashtu e-Gjoba do të ndërveprojë me sistemin e radarit të montuar në mjetin inteligjent.

Përmirësimi i sistemit për reflektimin e ndryshimeve të kodit rrugor mundëson që gjoba të regjistrohet bashkë me masat plotësuese. Riinxhinierizimi i sistemit, ka optimizuar performancën dhe sigurinë.

*Statusi dhjetor 2023:*

Realizuar

➤ **Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Skemat Kombëtare**

Projekti konsiston në përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Skema Kombëtare, sipas nevojave të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, në mbështetje të ndryshimeve ligjore.

Deri në fund të vitit 2022, u realizua faza përgatitore dhe analiza e biznesit për masat direkte, për secilën drejtori. Gjithashtu, ka përfunduar faza e analizës së biznesit me Drejtorinë e Monitorimeve.

Për masat direkte dhe ato të investimeve është në proces implementimi mekanizmi i autentifikimit duke përdorur platformën single-sign-on që AKSHI disponon. Në vijim do të kryhet faza e integritetit dhe testimit të sistemit të përmirësuar dhe trajnimi i përdoruesve.

*Statusi dhjetor 2023:*

Realizuar, skemat janë të prodhuara dhe në e-albania me status draft. Masat që kanë qene në 2022 dhe 2023 janë live. Gjithashtu po kryhen testimet e nevojshme dhe po shtohen masa të reja për përmirësimin.

➤ **Përmirësimi i sistemit të vaksinimit**

Sistemi informatik i regjistrimit kombëtar të vaksinimit do të shërbejë për proceset e regjistrimit, plan vaksinimit, alerte për vaksinimin, caktim vendi dhe ore si dhe azhurnim i vaksinave të kryera.

Do të mundësohet krijimi dhe azhurnimi i inventarizimeve dhe shpërndarjeve të vaksinave si dhe administrim optimal i stokut të vaksinave për Qendrat Shëndetësore. Gjatë vitit 2022 ka filluar puna për përmirësimin e sistemit të vaksinimit, duke pasur parasysh edhe problematikat kryesore që hasin përdoruesit dhe kryevaksinatorët gjatë përdorimit të tij.

*Statusi dhjetor 2023:*

Sistemi ka dalë live në nëntor 2023 dhe aktualisht është në fazë mirëmbajtjeje.

➤ **Sistemi elektronik i menaxhimit të vizitave dhe hyrje-daljeve në IEVP (Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale)**

Sistemi elektronik i menaxhimit të vizitave dhe hyrje-daljeve në IEVP është një platformë e integruar elektronike për menaxhimin dhe ndjekjen e vizitorëve, administratës dhe të dënuarve në hyrjen dhe daljen e tyre duke specifikuar të gjitha detajet e nevojshme të vizitës apo lëvizjes.

Ky sistem konsiston në minimizimin e hyrjeve në IEVP të personave të paautorizuar si dhe rrit sigurinë e aksesit në institucion.

U përfundua implementimi i sistemit në dhjetor 2022. Realizimi u konkretizua si më poshtë:

1. Krijimi i sistemit për menaxhimin e vizitorëve të të burgosurve, punonjësve të administratës dhe të burgosurit e të paraburgosurit
2. Integrim me sistemet e treta
3. Shërbim i dedikuar në e-albania
4. Furnizim, instalim në rang republike, dhe konfigurim i pajisjeve sipas specifikimeve teknike
5. Testimi i përgjithshëm funksional e teknik i sistemit
6. Hartimi i udhëzimeve dhe manualeve për përdoruesit fundorë. s
7. Fillimi i fazës së mirëmbajtjes gjatë së cilës vijon suporti i vazhdueshëm

*Statusi dhjetor 2023:*

Realizuar

➤ **Sistemi i hartës digjitale për hapësirat publike të mbuluara me kamera sigurie në rang vendi - për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

Objekti i këtij projekti është implementimi i sistemit informatik për administrimin digjital të regjistrimit të kamerave të Republikës së Shqipërisë, i cili do të përfshijë administrimin e hartës digjitale për kamerat e sigurisë nga Policia e Shtetit. Do të krijohet një bazë të dhënash me informacion të përgjithshëm për të gjitha kamerat e sigurisë të instaluar në ambientet publike. Në sistem do të kryhet hedhja dhe shfaqja në hartë e kamerave të sigurisë të instaluar si dhe fushëpamjes se tyre. Çdo subjekt mund të shtojë/heqë kamera sipas nevojave të biznesit. Me anë të projektit synohet rritja e efikasitetit të identifikimit të çdo kamere sigurie të instaluar në ambientet publike.

Me implementimin e këtij projekti Policia do të ketë mundësi të identifikojë dhe përpunojë më shpejt informacionin për kamerat e sigurisë në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Duke pasur informacionin digjital për pozicionin e kamerave të sigurisë dhe zonën e tyre të mbulimit, Policia

e Shtetit e ka më të lehtë identifikimin dhe kërkimin e pamjeve filmike për zona të caktuara në rastet e hetimit të krimeve. Ky sistem synon të ndihmojë në zbulimin e krimit brenda 48 orëve, duke gjurmuar dhe përdorur kamerat që vendosin bizneset apo individët.

Për çdo kamera të instaluar do të ruhet informacion i detajuar rreth vendndodhjes së tyre, kohës së instalimit, subjektit që e zotëron etj.

Në rastet e problemeve të identifikuara në një perimetër të caktuar, nëpërmjet sistemit duhet të identifikohen të gjitha kamerat e instaluar që mbulojnë perimetrin e kërkuar.

#### *Statusi dhjetor 2023:*

Sistemi është zhvilluar dhe aktualisht është në gjendje pune.

#### ➤ **Përmirësimi i sistemit të institutit të sigurimeve shoqërore**

Ka filluar puna me kontratën 42, date 21.12.2022, "Përmirësimi i sistemit të institutit të sigurimeve shoqërore"

Aktualisht është përfunduar lëvrimi i të gjitha pjesëve hardware, të cilat sipas kushteve të kontratës janë alokuar në datacenter e AKSHI dhe BCC në datacenter te ISSH.

Është bërë instalimi dhe vënia e tyre në punë.

- Është instaluar firewall i ri.
- Janë dërguar në DRSSH/DSSH dhe ALSSH, pajisjet e aksesit, të cilat janë instaluar dhe janë vënë në punë.
- Është vënë në punë sistemi i ri telefonik IP, si dhe është instaluar në ato DRSSH ku nuk kishte PI telefonike.
- Janë instaluar të gjitha licencat e teknologjisë bazë software..
- Është bërë migrimi i të dhënave të të gjitha sistemeve të ISSH nga serverat e vjetër në ata të rinj.

#### *Statusi Dhjetor 2023:*

Sipas kushteve të kontratës ka përfunduar dhe është realizuar në masën 100% faza e implementimit, aktualisht jemi në fazën e dytë të kontratës (faza e mirëmbajtjes së sistemit)

#### ➤ **Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë**

"Aktualisht Qendra e Shërbimeve Arsimore përdor sistemin e matrikullimit, i cili bazohet në sipas Kontratës MOES/G/SH/005/2011. Në bazë të udhëzimit nga MASR nr. 45, datë 19.12.2011, i cili përcaktonte qartë se QSHA-ja do të pajis me numër unik matrikullimi, cdo student, për cdo cikël studimi, në IAL Publike dhe Jo publike nga viti 2011-2012 e në vijim. Sistemi (SMIAL) bën të mundur gjenerimin e numrit unik të matrikullimit (NIM). Kjo databazë është krijuar prej vitit akademik 2011-2012 e në vijim. Cdo vit akademik kjo databazë ka të gjeneruar NIM sipas fushave përkatëse :Sistemi (SMIAL) bën të mundur gjenerimin e numrit

unik të matrikullimit (NIM). Kjo databazë është krijuar prej vitit akademik 2011-2012 e në vijim. Cdo vit akademik kjo databazë ka të gjeneruar NIM sipas fushave përkatëse:

- \*Institucion i Arsimit të Lartë Publik dhe Jopublik
- \*Fakulteti i IAL
- \*Cikli i studimit
- \*Programi i studimit
- \*Data e regjistrimit
- \*Të dhënat personale të studentit
- \* NIM( numri i matrikullimit)."

*Statusi dhjetor 2023:*

Janë firmosur nga GMK termat e referencës dhe testimi i tregut, përlogaritja e fondit limit dhe hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në pritje të procedurave më tej.

➤ **Përmirësimi i sistemit të referimit për ekzaminime të avancuara mjekësore (e-Referimi)**

Sistemi i referimit në kontratën dy vjecare të fundit, Qershor 2021- Qershor 2023 ka qenë vetëm në regjim mirëmbajtjeje dhe gjatë periudhës Janar 2023 deri më Qershor 2023 nuk janë kryer aktivitete. Vjimi i kontratës së re do të jetë vetëm në kuadër të regjimit të mirëmbajtjes, pa parashikuar përmirësime

Per periudhen qershor 2023- dhjetor 2023 eshte bere hartimi i termacve te references per kontraten e re te mirmbajtjes se lidhur ne janar 2024.

*Statusi dhjetor 2023 :*

Perfunduar dhe eshte ne faze mirembajtje

## 4. Konkluzione dhe rekomandime

Në përfundim të analizës së monitorimit të Strategjisë Agjenda Digjitale për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 nxjerrim këto konkluzione dhe rekomandime.

### **Konkluzione:**

Plani i Veprimit i Strategjisë së Agjendës Digjitale 2022 - 2026 përfshin në total 47 aktivitete bazë për t'u implementuar deri më vitin 2026.

Për sa i përket statusit të projekteve në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023, numri i projekteve të implementuara është 17, 10 projekte janë në fazën e implementimit, 9 projekte janë në proces hartimi të termave të referencës dhe në fazë konceptimi dhe 11 projekte nuk kanë gjetur nisje dhe zbatim për arsye financiare, apo arsye të tjera.

**Rekomandime për fazat në vijim:**

- Të merren masa më të mira për të identifikuar në kohë projektet me risk mosrealizimi;
- Të kihen parasysh vështirësitë e projekteve ekzistuese për t'u mitiguar më mirë në projektet që do të zbatohen në vijim;
- Të mundësohet një koordinim më i mirë me kontributet nga të gjithë institucionet;